



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Përhershëm për Punën dhe Çështjet Sociale
RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 2 datë 16-10-2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 9 datë 11/09/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Gusht 2025"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr 57/2019, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"; Mbi zbatimin e vendimit Nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 02, datë 09.02.2024, Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit të ndihmës ekonomike" VKM nr.8 dt.14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtesave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj".

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social pas verifikimeve të kryera në familje dhe përlllogaritjes së fondit 6% të ndihmës ekonomike rekomandoi 29 familje me fond 98.693 lekë për muajin gusht 2025.

Drejtoria / Spektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni për punën dhe çështjet sociale dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Çështjeve Sociale.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive të varfra në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun Komisioni për Shërbime Publike dhe Prona, i mbledhur me datën 16/10/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 9 datë 11/09/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit gusht 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Lezo Kolaj

(emri, mbiemri, firma)

ALFONS GJERGJAJ

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Dhitar Asani

Datë 16.10.2025